

**UNITED  
NATIONS**

United Nations  
Interim  
Administration  
Mission  
in Kosovo



**UNMIK**

**NATIONS UNIES**

Mission  
d'Administration  
Intérimaire des  
Nations Unies au  
Kosovo

**PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT**

**KUVENDI I KOSOVËS  
СКУПШТИНА КОСОВА  
ASSEMBLY OF KOSOVO**

**Ligjislatura e dytë**

Komisioni për Shëndetësi, Punë  
dhe Mirëqenie Sociale  
Nr. 29/2007

***PROCESVE BAL***

*i mbledhjes së Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, të mbajtur më 9. 10. 2007, në sallën N-225, në orën 11.00*

**Të pranishëm:** Fatmire Mulhaxha- Kollçaku, kryetare: Shpresa Murati, Nafije Berisha, Ilaz Pireva, Rudina Bukoshi, Flora Brovina, Teuta Hadri, Fehmi Vula, Zylfije Hundozi, Ferid Agani dhe Zahrije Jusufi

**Morën pjesë**

Haliti Ferizi nga Hendikosi

Mbledhjen e drejtoi **Fatmire Mulhaxha – Kollçaku** dhe propozoi këtë:

**REND DITE**

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes se kaluar;
2. Shqyrtimi i Projektligjit për Rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara;
3. Marrja e qëndrimit lidhur me Projektligjet e papërfunduara të lëmisë së punës.

**Rendi i ditës u miratua.**

U hap shqyrtimi për pikën e parë

## **1 Miratimi i procesverbalit të mbledhjes se kaluar ,**

Pasi nuk u dhanë vërejtje , u miratua.

U hap shqyrtimi për pikën e dytë

## **2 Shqyrtimi i Projektligjit për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuar**

**Fatmire Mulhaxha –Kollçaku**, përshëndeti përfaqësuesin e Hendikosit dhe e ftoi që të raportojë lidhur me vërejtjet në Projektligjin për rehabilitimin profesional të personave me aftësi të kufizuar

**Halit Ferizi** nga Hendikosi përshëndeti të pranishmit dhe falënderoi Komisionin për punën që është duke bërë në mbështetjen e kësaj kategorisë të personave me aftësi të kufizuara . Ai komentet i fokusoi në mungesën e Projektligjit të punës Në vazhdim lidhur me Projektligjin ceku se ky duhet të jetë në pajtueshmëri me konventetat ndërkombëtare

Gjatë amendamentimit duhet të korrigojen fjalitë e tekstit të Projektligjit të cilat e humbin kuptimin e nocionit të normuar me konventat ndërkombëtare Ai foli për brendinë e projektligjit dhe gjatë amendamentimit do të japë kontributin. Pastaj kërkoi në nenin 10 të Projektligjit pikën e dytë në rreshtin e pestë të fshihen falët arsimore dhe shëndetësore i propozoi Komisionit si pikë e re t'i shtohen si vijon: duke siguruar përdorimin e gjuhës se shenjave për të shurdh dhe alfabetit të brailit për të verbër. Nenit 18 propozoi t'i shtohet paragraf i ri me këtë përmbajtje : Varësisht nga shkalla dhe lloji i aftësisë së kufizuar, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale me akt të veçantë nënligjor, do rregullojë dhe përcaktojë vendet e punës dhe punët e përshtatshme për personat me aftësi të kufizuar duke i dhënë përparsi me aftësi të kufizuar mbi 90%

**Flora Brovina** kërkoi të vazhdohet sipas tabelës krahasuese. Ajo i paraqiti amendamentet si vijon : Amendamenti 1 ka të bëjë me ndryshimin e titullit të Projektligjit për aftësimin e riaftësimin profesional dhe punësim të personave me aftësi të kufizuara. Pastaj , amendamente i propozoi si vijon: nenit 2, neneve 3,2,4,5 ,11,12,15 nenit 4.4 nenit 5.3 titullit të kapitullit III nenit 6.3 ,4 nenit 10 ,2 nenit 11,4 nenit 13 ,4 nenit 14.1,2 ,7 nenit 17,2 u propozua të hiqet nenit 18 i shtohet pikë e re nenit 19 ,1 i shtohet pikë re ,neni 21 fshihet neni 25,2 neni 27,1 ,3 nenit 28,1 i shtohet pikë e re

Fatmire Mulhaxha- Kollçaku, Shpresa Murati, Ilaz Pireva, Rudina Bukoshi, Flora Brovina, Fehmi Vula, Zylfije Hundozi,Teuta Hadri, Ferid Agani dhe Zahrije Jusufi si dhe Halit Ferizi kontribuan për hartimin e amendamenteve .

Komisioni i miratoi amendamentet në terësi lidhur me Projektligjin për rehabilitimin profesional të personave me aftësi të kufizuara dhe ka rekomandua Kuvendit të Kosovës për miratimin e tyre . Komisioni e ngarkoi Flora Brovinën të përgatitë raportin përfundimtar lidhur me Projektligjin për Kuvend .

Në fund u kërkua që znj. Zahrije Jusufi të përgatisë raportin lidhur me Projektligjin për përkrahjen materiale të familjeve të fëmijëve me aftës të kufizuara **Fatmire Mulhaxha- Kollçaku** lidhur me Projektligjin për përkrahjen materiale të familjeve të fëmijëve me aftës të kufizuara i propozoi Komisionit mos t'i kthehet Qeverisë pasi ka kosto të ultë buxhetore dhe është i nevojshëm për lëmin që ky e rregullon..

U hap shqyrtimi për pikën e tretë

### **3 Marrja e qëndrimit lidhur me Projektligjet te papërfunduara në lëmin e punës.**

**Fatmire Mulhaxha- Kollçaku** vuri re se në Komision kanë ngelur një numër i projektligjeve të papërfunduara dhe se për këtë kemi biseduar në takimin e përbashkët me kryetarët e komisioneve dhe me kryetarin e Kuvendit. . Mirëpo , disa edhe pse kemi pasur dëshirë t'i përfundojmë ngase përmbajnë implikime buxhetore të cilat kanë rezultuar nga Fondi Monetarë Ndërkombëtar . Ajo ceku se fjala është për Projektligjin e punës, Projektligjin për organizimin e grevave dhe atë për organizimin sindikal dhe lidhur me këtë ftoi anëtarët për debat.

**Zylfije Hundozi** ishte e mendimit se të gjitha ato Projektligje që nuk e kanë koston finasiare si dhe ato për të cilat kërkohet zbatimi i tyre pas 2010 do të duhej t'i kthehen Qeverisë se Kosovës në ripunim. Prandaj ,ajo ceku pse të punohet ne ato ligje kur nuk zbatohen

Deputetë Rudina Bukoshi, Flora Brovina, Fehmi Vula, Zylfije Hundozi, Teuta Hadri, Ferid Agani dhe Zahrije Jusufi kontribuan në diskutimin e tyre në marrjen e përfundimit dhe lidhur me këtë Komisioni nxori këtë :

### **P ë r f u n d i m**

**I** Komisioni i rekomandon Kuvendit të Kosovës që Projektligjin e punës, Projektligjin për organizimin sindikal dhe Projektligjin e Grevave t'i kthehen propozuesit - Qeverisë së Kosovës

**Ilaz Pireva** ngriti serish çështjen e mosdhënies se përgjegjjes se ministrit të Punës lidhur me Projektligjin për Inspektoratin e punës

**Mbledhja përfundoi në orën 13,30**

Procesmbajtës,  
Rrahim Demaj – zyrtar i lartë ligjor

**Kryetarja e Komisionit  
Fatmire Mulhaxha- Kollçaku**